



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2021

**MBLEDHJA Nr. 26,  
datë 17.05.2021, ora 12:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 17.05.2021, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 26 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për rinovimin e licences nr. 343, seria F16 për furnizimin e energjise elektrike
2. Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”
3. Mbi miratimin e rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)
4. Informacion mbi monitorimin e kryer pranë qendrave të kujdesit të klientit (KNK) të shoqërisë FSHU sh.a me qëllim të performancës të punonjësve sa i përket njohurive mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të licencuar FSHU sh.a dhe OSSH sh.a dhe adresimit të saktë të kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e

seancave dëgjimore teknike apo publike. Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**